



KOLEGJI AAB - KAMPUSI
Zona Industriale Prishtinë - Fushë Kosovë
FAKULTETI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
Kërkesa i drejtohet: Dekanatit

Programi për Studimet: Master

Emri i plotë i programit të studimit: Administratë Publike dhe Diplomaci

Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës, tezat dhe projekt për temën e diplomës

Kandidati: Vlora Rexha, Prishtinë

Titulli i Temës: Ndërtimi i sigurisë ndërkombëtare dhe sfidat sipas trendëve bashkëkohore

Propozimi për mentor: Prof. Ass. Dr. Dashnim Ismajli

Përshkrimi i shkurtër i temës:

- Në kapitullin e parë trajtojmë dhe analizojmë bazën teorike dhe konceptuale mbi sigurinë në përgjithësi dhe mendimet e autorëve të ndryshëm mbi përkufizimet e sigurisë në nivelin individual, kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu kapitulli i parë merret edhe me studimin e doktrinave të ndryshme mbi sistemin e sigurisë ndërkombëtare në planin abstrakt teorik.
- Në kapitullin e dytë; siguria trajtohet nga këndvështrimi i dy teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare. Perspektiva liberale na ofron tablonë e saj se si bota do të dukej më mirë dhe më e sigurt nga ç'është përmesë tre komponenteve të saj; teorive të demokratizmit, ndërvarësisë së ekonomisë ndërkombëtare, institucioneve ndërkombëtare si parim për sistemin e sigurisë kolektive. Në të kundërtën e kësaj, teorit realiste shpjegimet liberale i konsiderojn si shumë të "sheqerosura" dhe në vend të tyre ata ofrojnë paqyrimin real të kushtëzuar të sigurisë ndërkombëtare përmes këtyre pandehmave; Natyra e sistemit ndërkombëtar, motivet dhe veprimet e shteteve; mbijetesa; vetëndihma dhe frika dhe politika e pushtetit si percaktues i paqës dhe sigurisë ndërkombëtare. Sa kanë të drejtë dhe ku qendron e vërteta mbi sigurinë, dhe një botë më paqësore përgjigja do të jetë në pjesën e "debatit" ndërmjet këtyre teorive.